

Mirel Josa: Skuadra eshte e kompletuar, ja dalim edhe pa perforcime

nga AlbaniaSoccer

E shtunë, 21 Dhjetor 2013 17:40



Edhe me nje lojtar me pak ne fushe, skuadra kampione arriti te fitoi dhe trajneri Mirel Josa shprehu kenaqesine e tij per lojen e forte qe skuadra e tij zhvilloi. "Erdhem per fitore ne Lushnje edhe ja arriem, ndonese luajtem me 10 lojtare. Zhvilluam nje loje te mire. Jam i kenaqur nga loja e djemve te cilet gjithnje i jane pergjigjur kerkesave te mija. Kemi nje grup te mire lojtaresh dhe mund te vazhdojme pa perforcime nese nuk kemi demtime. Takimi i sotem tregoi vlera pasi nuk eshte e lehte te fitosh ne Lushnje. Ekipi ka nje tifozeri te madhe. Une kam punuar ketu dhe simpatizuesit bejne shume per skuadren e tyre. I uroj tifozave te Skenderbeut dhe tifozat e gjithë Shqiperise te kalojne Festa te bukura dhe te harrojme te gjitha peroblemet qe patem", perfundoi Josa